



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Podujevës
Opština Podujevë / Municipality of Podujeva



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Data: 24.04.2025

Nr. prot: 13-101/03-0023084/25

Bazuar në nenin 77, 78, 79, 80, 81, 82 dhe nenin 83 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenin 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika D të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenet 8, 13 dhe 16 të Rregullores (QRK) 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukuesve dhe Sekretarëve të Institucioneve Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, NJMBNJ shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Titulli i vendit të punës: Drejtor/e / Zëvendësdrejtor/e në ShFMU dhe në IAAP

Koeficienti/paga:

- Drejtor në ShFMU E14 6.7
- Zëvendësdrejtor/e E15 6.5
- Drejtor në IAAP E13 6.8
- Zëvendësdrejtor/e E14 6.7

Afati i aplikimit: 25.04.2025 deri 25.05.2025

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat në të njëtin Institucion Shkollor.

Nr.	Shkolla	Vendi	Pozita
1	ShFMU “Nuhi Gashi”	Bradash	Drejtor/e
2	ShFMU “Hamit Sejdiu”	Kërpimëh	Drejtor/e
3	ShFMU “Afrimi e Fahriu”	Lluzhan	Drejtor/e
4	Qerdhja “Armela”	Podujevë	Drejtor/e
5	IAAP “Fan S.Noli”	Podujevë	Drejtor/e
6	IAAP “Fan S.Noli”	Podujevë	Zëvendësdrejtor/e

7	Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”	Podujevë	Zëvendësdrejtor/e
8	ShFMU “Enver Maloku”	Podujevë	Drejtor/e
9	ShFMU “Zenel Hajdini”	Lupç i Poshtëm	Drejtor/e
10	ShFMU “Zahir Pajaziti”	Orllan	Drejtor/e
11	ShFMU “Luigj Gurakuqi”	Batllavë	Drejtor/e
12	ShFMU “Dr. Ibrahim Rugova”	Podujevë	Drejtor/e
13	SHFMU " Dr.Ibrahim Rugova "	Podujevë	Zëvendësdrejtor/e
14	ShFMU “Lasgush Poradeci”	Dumnicë	Drejtor/e
15	SHFMU " Dëshmorët e Kombit "	Podujevë	Drejtor/e
16	SHFMU " Rilindja "	Herticë	Drejtor/e
17	SHFMU " Naum Veqilharxhi "	Llapashticë e Epërme	Drejtor/e
18	SHFMU " Ali Ajeti "	Sfeçël	Drejtor/e
19	SHFMU " Shefki Kuleta "	Tërrnavë	Drejtor/e
20	SHFMU " Kadri Kadriu "	Llaushë	Drejtor/e
21	SHFMU " Sheqë Mirofci "	Shtedim	Drejtor/e
22	SHFMU " Dituria "	Llapashticë e Poshtme	Drejtor/e
23	SHFMU " Kongresi i Manastirit "	Gllamnik	Drejtor/e
24	SHFMU " Hasan Ramadani "	Shajkoc	Drejtor/e
25	SHFMU " Eqrem Çabej "	Buricë	Drejtor/e
26	SHFMU “Ali Hadri”	Obrançë	Drejtor/e
27	SHFMU " Elfir Behrami "	Metehi	Drejtor/e

1. Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs

1. Kandidatët e interesuar për të konkurruar për drejtor/eshë dhe zëvendësdrejtor/eshë të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (në vijim: IEAA-AP) duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - 1.4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
 - 1.5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
 - 1.6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndëne institucion publik;
 - 1.7. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi;
 - 1.8. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - 1.9. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 - 1.10. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - 1.11. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit/ses sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
 - 1.12. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
 - 1.13. Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimdhënës/e në IEAA-AP.
 - 1.14. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në legjislacioni në fuqi
2. Përgjithësisht paragrafit 1.1. shtetasit e huaj mund të aplikojnë kur kjo lejohet sipas legjislacioni në fuqi për zyrtarët publik.

2. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të posedojnë këto dokumente:

- 2.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit sipas pikave 1.7, 1.8, 1.9 apo 1.10 sipas pikës 2 të këtij konkursi;
- 2.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- 2.3. Nëse kandidati/ja ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzojë dëshminë/certifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim sipas pikës 1.12 të këtij neni;
- 2.4. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- 2.5. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

- 2.6. Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 2.7. Vërtetimin e përvojës së punës në procesin edukativo-arsimor, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- 2.8. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- 2.9. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në formularët e Rregullores 19 /2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe
- 2.10 aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitarPër pozitat e drejtorëve të shkollave, kandidatët dorëzojnë konceptin e një plani zhvillimor të shkollës, i cili përshkruan konkretisht mënyrën dhe strategjinë përmes së cilës do të përmirësohet cilësia menaxheriale e shkollës, mësimitdhënia dhe rezultatet e nxënësve të shkollës.

Vlerësimi i kandidatëve:

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:

- a) **Testit me shkrim**, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë
- b) **Intervista me gojë**, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm, nga to 30% prezentimi i konceptit të planit zhvillimor të shkollës, dhe 20% portfolio profesionale.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë për drejtorë

Drejtori i IEAAP ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimi dhe përditësimi i të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e më simdhënëve, vlerësimin e më simdhënëve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me më simdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucion edukativoarsimor, duke përfshirë dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë për zv. Drejtorë

Zëvendësdyrektori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështet dhe ndihmojë punën e drejtor -it/es për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, ai/ajo ka për detyrë të:

- Përkujdeset dhe përcjell mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ndihmojë në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
- Monitoron dhe mentoron mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Përpunon statistikën e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
- Përgatitë raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
- Kontrollon ditarët e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;
- Ndihmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
- Zëvendëson mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;
- Pranon, kontrollon dhe sistemon përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
- Zëvendëson dhe përfaqëson drejtorin e institucionit shkollor sipas nevojës;
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/eshë e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Procedurat e konkurimit:

Konkurimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim, të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit, dispozitat e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat Publike, Rregullores (QRK) nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdyrektorëve, mësimdhënësve, bashkpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe Sekretarëve në institucione publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 si dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën për Shërbim me Qytetarë, nga ora 08:00 deri 16:00 çdo ditë pune, në Komunën e Podujevës, aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga web-faqja <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi përmes email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumentet origjinale/noterizuar të kualifikimit që i kanë kryer.

Në rast të mos dorëzimit të dokumentacionit origjinal/noterizuar, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet do të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve>